

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 195 Prot.

Tiranë, më 17.03 2015

**VENDIM Nr. 23, datë 11.03.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, të datës 11.03.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për "Rishikim i vendimit të KKA nr. 12, datë 18.02.2015 për projektin "Ndërtimi i linjës së transmetimit 110kv Llapaj-Peshkopi", paraqitur nga "OST" sh.a.,

**VENDOSI:**

- I. Të kryhen sondazhe arkeologjike nga subjekt privat i licensuar, duke lidhur aktmarrëveshje përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, për pozicionet e shtyllave të linjës së transmetimit 110kv Llapaj-Peshkopi, të cilat mbivendosen në zonën e njohur me potencial arkeologjik të fushës së Kastriotit.
- II. Gjatë zbatimit të punimeve për pjesën tjetër të projektit të kësaj linje, të realizohet mbikqyrja e vazhdueshme arkeologjike nga arkeologët e DRKK Shkodër, në bashkëpunim me arkeologët e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**